



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Laç, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**Shtojca 11**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT  
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 31.01.2025

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, me numër NIPTI **L01606034A**,  
**Adresa:** Tirane Tirane TIRANE Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

**Tipi i Kontratës:** Mallra

**Lloji i Procedurës së prokurimit:** “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** **REF-32511-12-10-2024**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “F-V e paisjeve për mobilim, ndricim dhe foni në sallën e shfaqjeve të Pallatit të Kulturës”.

**Fondi limit:** **8,333,333** (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:** 11.12.2024

**Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike:** Nr.87, datë 16.12.2024.

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

**Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. Operatori ekonomik “GLOBAL ELECTRONICS” SHPK, me numër NIPTI **L12206017A**.

**Vlera e ofertuar: 7,900,000** (shtatë milion e nëntëqind e mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, me numër NIPTI L01606034A.  
Vlera e ofertuar: 7,923,000 (shtatë milion e nëntëqind e njëzet e tre mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “FREDI ELECTRONIC” SHPK, me numër NIPTI K91803020F.  
Vlera e ofertuar: 7,998,900 (shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori ekonomik “GLOBAL ELECTRONICS” SHPK, me numër NIPTI L12206017A.

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ...., si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

- **Operatori ekonomik “GLOBAL ELECTRONICS” SHPK, ka plotësuar gabim Shtojcën 3 “Lista e çmimeve të artikujve”.**

Në DST, tek **Seksioni I “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, germa B “Përgatitja e ofertave”, pika 4 “Formularët e Ofertës dhe Listat e Çmimeve”,** parashikohet shprehimisht se: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: **Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.**

Sqarojmë se OE ka plotësuar gabim Shtojcën 3 “Lista e çmimeve të artikujve”, konkretisht ka ndryshuar/zëvendësuar sasinë në numrin rendor të artikujve Nr.5 dhe Nr.13.

Për artikullin Nr.5 “Kabell Audio”, OE ka vendosur sasinë 200 ml, ndërsa AK në DST ka kërkuar sasinë 170 ml.

Për artikullin Nr.13 “Prozektore Theatre me Led 200 watt CW WW”, OE ka vendosur sasinë 16 cope, ndërsa AK në DST ka kërkuar sasinë 32 cope.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**PC STORE**” **SHPK**, me adresë: Tirane Tirane TIRANE Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **7,923,000** (shtatë milion e nëntëqind e njëzet e tre mijë) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si fitues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**  
**Majlinda CARA**